

INFORMACION PER FAQEN E INTERNETIT TE BKT-se BAZUAR MBI PARIMET E UDHËHEQJES SE KORPORATES

Përditësuar më 31 dhjetor 2024

1.POLITIKA E SHPËRNDARJES SË FITIMIT

Mekanizmi i vendimmarrjes per shpërndarjen e fitimit tek Banka Kombëtare Tregtare ("BKT" ose "Banka") përbëhet nga rekomandimi i bere nga Keshilli Drejtues dhe miratimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve në BKT mbahet të paktën një herë në vit, duke synuar që të miratojë pasqyrat financiare të Bankës dhe të vendosë për shpërndarjen e fitimit te vitit te fundit financiar të mbyllur.

Bazuar në vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, të gjitha fitimet e realizuara nga BKT gjatë viteve financiare 2000-2015 janë kapitalizuar dhe janë përdorur nga Banka për të mbeshtetur zmadhimin e vazhdueshëm të bilancit dhe për të rritur fitimin.

Më 30 mars 2017 Banka realizoi shpërndarjen e parë të dividendit tek Aksioneri i saj.

Mbledhja e Përgjithshme datë 27 mars 2024, miratoi rezolutën Nr. 2 si më poshtë:

"Miratohen pasqyrat financiare statutore dhe SNRF të audituara nga "Forvis Mazars" sh.p.k., për vitin financiar mbyllur më 31 dhjetor 2023".

Që sipas rekomandimit të Këshillit Drejtues, fitimi neto i BKT për vitin 2023: 7,861,575,600 Lekë dhe vlera e akumuluar nga fitimi i pashpërndarë i vitit 2022 në shumën 6,358,631,748 Lekë të përdoret si më poshtë:

- a) Një pjesë e fitimit neto të vitit 2023: 393,078,780 Lekë do të përdoret si rezervë ligjore bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- b) Një pjesë e fitimit të akumuluar të pashpërndarë të vitit 2022: 4,826,000,004.83 Lekë, ekuivalenti në 50,000,000.05 USD, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e sotme, USD 1.00 = Lekë 96.52, do të përdoret për rritje kapitali i autorizuar dhe i paguar i BKT-së, nëpërmjet emëtimit të aksioneve të reja.
- c) Pjesa e mbetur e fitimit të akumuluar të pashpërndarë të vitit 2022: 1,532,631,743.17 Lekë dhe një pjesë e fitimit neto të vitit 2023: 3,293,368,256.83 Lekë, totali në 4,826,000,000 Lekë, ekuivalenti në 50,000,000 USD, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e sotme, USD 1.00 = Lekë 96.52, do të përdoret për t'u shpërndarë si dividend tek Çalik Holding A.Ş., si aksioner i vetëm i BKT-së.
- d) Pjesa e mbetur e fitimit neto për vitin 2023: 4,175,128,563 Lekë do të mbahet si fitim i pashpërndarë.

Në rezolutën nr. 9 "FORVIS MAZARS" sh.p.k. emërohet si auditor i jashtëm i Bankës (Ekspert Kontabël i Autorizuar) për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2024.